



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 172, datë 03.11.2023

**PËR MOSMIRATIMIN E PROPOZIMIT TË SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS
KANALIZIME DURRËS SHA PËR PLANIN E RI TARIFOR TË FURNIZIMIT ME UJË
TË PIJSHËM DHE LARGIMIT, TRAJTIMIT DHE PËRPUNIMIT TË UJRAVE TË
NDOTURA PËR BASHKINË DURRËS**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; nenit 22, pika 2 të Ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujrave të ndotura”, të ndryshuar; neni 13 të Vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr.539, datë 30.12.2021 “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime”, Shkresës nr.4244/3, datë 28.08.2023 të Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sha. Këshilli Bashkiak në mbledhjen plenare të datës 03.11.2023, pasi mori në shqyrtim projektvendimin dhe relacionin e propozuar nga Kryetarja e Bashkisë me shkresë nr.10222/2 prot , datë 01.11.2023,

V E N D O S I :

1. Mosmiratimin e propozimit të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sha për planin e ri tarifor të furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujrave të ndotura për Bashkinë Durrës, sipas tabelës në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkisë, Drejtorja e Shërbimeve Publike dhe Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sha.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 06.11.2023



Lidhja nr. 1

Kategoria e Klienteve		Zona e Sherbimit	
		Tarifat Aktuale	Tarifat e Propozuara
A.Sherbimi Furnizim me uje		Lek/m3	Lek/m3
NJO Durres	Kliente Familjare	70	70
	Kliente Publik	120	140
	Kliente Privat	130	150
B.Sherbimi Kanalizim UN		Lek/m3	Lek/m3
NJO Durres	Kliente Familjare	50	50
	Kliente Publik	60	70
	Kliente Privat	60	70
C.Tarife Fikse Sherbimi		Lek/fature	Lek/fature
NJO Durres	Kliente Familjare	150	200
	Kliente Publik	150	300
	Kliente Privat	150	300





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 708 Prot.
112

Durrës, më 08.11.2023

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit



**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.172 datë 03.11.2023 “Për mosmiratimin e propozimit të shoqërisë rajonale ujësjellës kanalizime Durrës SHA për planin e ri tarifor të furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujrave të ndotura për bashkinë Durrës”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

